



Ndal Punës së Fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve
nëpërmjet edukimit,
artit dhe medias

Kërkimi dhe informacioni

Objektivi: Zbulimi i fakteve dhe shifrave për punën e fëmijëve, p.sh., konventat kryesore ndërkombëtare. Të mësosh të zhvillosh një proces kërkimor të thelluar për një çështje, duke shfrytëzuar burime të ndryshme, përfshirë dhe internetin



Përfundimi: Promovimi i njohurive kryesore për të drejtat themelore të njeriut dhe veçanërisht për të drejtat e fëmijëve. Lehtësimi i njohjes së lidhjeve mbi bazën e të cilave funksionon shoqëria, si dhe njohja e rregullave që disiplinojnë sjelljen e njeriut.



Koha

6 orë mësimi të veçanta dhe dy orë mësimi së bashku

Motivimi

Bota në të cilën jetojmë, është rezultat i një sërë lidhjesh që pasurohen dita-ditës. Është e rëndësishme që të rinjtë të kuptojnë se edhe ata janë pjesë e këtij rrjeti lidhjesh që i vë ata në marrëdhënie me bashkëmoshatarët e tyre në vende të tjera. Asgjë nuk ndodh kot. Krizat e ekonomike, shoqërore dhe mjedisore, pavarësisht se ku ndodhin, kanë rrjedhoja për të gjithë planetin. Sot, nëpërmjet medias pasqyrohet gjithçka që ndodh. Bota bëhet gjithmonë dhe më e vogël dhe shprehja "fshati ynë global", po i afrohet gjithmonë e më shumë të vërtetës.

Një ndër qëllimet e këtyre moduleve është krijimi i një rrjeti lidhjesh ndërmjet të rinjve të vendeve të

Shënim për përdoruesin

Ju këshillojmë që ky modul të zhvillohet në fillim të programit. Ky modul do t'i ushtrojë të rinjtë të zhvillojnë punë kërkimore që do të shërbejë edhe për realizimin e moduleve të tjera. Mirë është që të pasohet nga realizimi i moduleve "Intervista dhe sondazhe" dhe "Debati dhe komunikimi". Në radhë të parë, të rinjtë e grupit duhet të fitojnë besim në vetëvete pasi disa prej ushtrimeve të këtij moduli nuk janë shumë të lehta për t'u kryer, veçanërisht kur u duhet të punojnë më vete.



pazhvilluara dhe vendeve të industrializuara, të rinjve të rajoneve që janë në luftë me ata të rajoneve ku mbretëron paqja, ndërmjet të rinjve që punojnë dhe të rinjve që kanë fatin të arsimohen dhe të kenë një familje të stabilizuar. Që ky program të ketë sukses, duhet që këto lidhje të forcohen dhe të karakterizohen nga ndjenja e solidaritetit.

Informacioni për punën e fëmijëve mund të gjendet në burime të ndryshme, ndërmjet të cilave dhe në internet, ku mund të gjesh statistika, çështje të trajtimit juridik të punës së fëmijëve, veprimtari që synojnë mënjanimin e saj të plotë, nëpërmjet ndihmës që u jepet të rinjve dhe familjeve të tyre, fushata që janë në zhvillim e sipër etj. Të rinjtë duhet të ndërgjegjësohen për ekzistencën e këtij informacioni dhe të mësohen si ta gjejnë dhe ta shfrytëzojnë atë. Natyra e moduleve është e tillë që u jep mundësi të rinjve të grupit të pasurojnë më tej këtë informacion jo me statistika, por me raste konkrete, me veprimtari të zhvilluara nga ata vetë, duke dhënë kështu ndihmesën e tyre në fushatën botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve.

Të rinjtë duhet të kuptojnë se, si qytetarë të botës, edhe ata janë përgjegjës për gjithçka që ndodh, qofshin ato të mira apo jo. Nëse shoqëria, veçanërisht ajo pjesë e shoqërisë që ka pushtetin, dëshiron që të rinjtë të jenë përgjegjës, duhet të punojë dhe t'i ndihmojë ata të marrë përgjegjësi mbi veten. Ky modul synon të ngjallë ndjenjën e përgjegjësisë së të rinjve ndaj kësaj dukurie dhe, të ndihmuar edhe nga modulet e tjera, të rinjtë të pajisin me mjete e nevojshme për të vepruar. Qëllimi është i dyfishtë. Nga njëra anë, t'i ndihmosh të rinjtë të marrin informacionin që është në dispozicion, dhe më vonë, ta thellojnë atë nëpërmjet intervistimeve të personave me rëndësi të komunitetit dhe të botës ekonomike.

Duke realizuar këtë modul, të rinjtë do të kuptojnë që, pavarësisht se mënjanimi i plotë i punës së fëmijëve është një problem shumë i vështirë. Ata nuk janë të vetëm në përpjekjet e tyre. Ka shumë organizata, grupe njerëzish dhe individë të veçantë që punojnë për zgjidhjen e këtij problemi. Më tej, të rinjtë do të njihen

me ligjet dhe rregulloret në nivel kombëtar që ndihmojnë institucionet shtetërore të luajnë rolin e tyre për mënjanimi e plotë të punës së fëmijëve.

Një ndër aspektet më të vështirë për t'u kuptuar nga të rinjtë lidhet me faktin që edhe pse janë bërë përpjekje të mëdha, në nivel ndërkombëtar, për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve, kjo dukuri ende ekziston. Ja përse duhet që të gjithë së bashku, të gjithë brezat, të punojnë derisa, një ditë, të gjithë fëmijët e botës të mund të jetojnë të lirë, të mbrojtur dhe të sigurtë.

Përgatitja

Për të siguruar përfshirjen e komunitetit në realizimin e modulit, duhet të mendoni për personat që mund t'ju sigurojnë burimet e informacionit, si dhe për ata persona që mund t'ju japin fakte konkrete.


Një ndër burimet e rëndësishme të informacionit janë bibliotekat e të gjitha niveleve, duke përfshirë dhe ato të shkollave. Lidhuni me përgjegjësit e bibliotekave të ndryshme të qytetit tuaj dhe vlerësoni rolin e tyre në informacionin që mund t'ju sigurojnë në realizimin e modulit. Do të ishte shumë mirë që gjatë realizimit të modulit të kishit në dispozicion kompjuter dhe lidhje me internetin.

Merrni takim me përgjegjësin e bibliotekës më të afërt, shpjegojini qëllimin e projektit tuaj dhe sigurohuni që t'ju vërë në dispozicion personin që t'ju mësojë si të kërkoni informacionin në dokumentet dhe librat e bibliotekës. Nëse janë të lidhur me internetin, kërkoni që t'i mësojnë të rinjtë e grupit të shfrytëzojnë këtë burim. Interneti ka informacion të mjaftueshëm për punën e fëmijëve dhe është mirë që të rinjtë të futen në këtë informacion.

Gjithashtu, biblioteka mund të vërë në dispozicion të grupit një listë me libra që trajtojnë punën e fëmijëve, shfrytëzimin e të vegjëlve, si dhe çështje të tjera që lidhen me to. Shumë shkrimtarë trajtojnë temën e të drejtave shoqërore.

Bibliotekat





Biblioteka është vendi i duhur për t'u njohur me ta dhe librat e tyre, duke i nxitur të rinjtë të lexojnë më shumë për këtë problem.




Shënim për përdoruesin

Realizimi i moduleve bëhet nëpërmjet formave të ndryshme të artit. Në këto kushte, fjala e shkruar luan një rol shumë të madh. Shfrytëzoheni këtë moment për të lexuar modulën "Shkrimi artistik" dhe të filloni të planifikoni realizimin e integruar të të dyja moduleve. Ftojini shkrimtarët e njohur të komunitetit tuaj, nëse ka ta tillë, t'ju ndihmojnë në realizimin e modulit "Shkrimi krijues". Takohuni me ta dhe paraqituni projektin. Ftojini të bisedojnë me të rinjtë e grupit dhe të nxjerrin në pah fuqinë e fjalës në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Gjatë periudhës së realizimi të modulit mund t'i kërkoni bibliotekës të ngrejë një kënd me literaturë për punën e fëmijëve. Nëse projekti zhvillohet në shkollë, kjo mund të ketë një ndikim të rëndësishëm tek nxënësit e tjerë që do të çuditën dhe do të bëhen kuriozë nga shfaqja e një këndi të tillë në bibliotekën e shkollës. Nga ana tjetër, edhe pjesëtarë të tjerë të komunitetit, që shfrytëzojnë bibliotekën, do të ndërëgjegjësohen nga ngritja e këtij këndi. IPEC-u, gjithashtu, ka shumë materiale që mund t'i vërë në dispozicion të atyre që i kërkojnë. Gjithnjë në bashkëpunim me bibliotekën, hapni një ekspozitë me libra që trajtojnë problemin e punës së fëmijëve, si dhe me libra që flasin për të drejtat e tyre. Në të mund të paraqisni edhe broshura, raporte të ndryshme me statistika për fëmijët, madje edhe punime të vetë fëmijëve (vizatime, grafika etj.). Realizimi i tyre do të rrisë ndjenjën e përgjegjësisë në gjirin e grupit, si dhe të krenarisë për atë që bëjnë së bashku në lidhje me punën e fëmijëve.

Integrimi i komunitetit



Në shumë vende, një burim tjetër informacioni janë sindikatat, organizatat e punëtorëve dhe OJF-të. Sindikatat, si përfaqësuese të punëtorëve, mbrojnë të drejtat dhe interesa e punëtorëve dhe të familjeve të tyre. Sindikatat mund të japin informacion për të drejtat e punëtorëve në përgjithësi, për të drejtat e punëtorëve të rinj, për punëtorët që punojnë me kohë të pjesshme, për shërbimet që u siguron sindikata etj. Nga ana tjetër, sindikatat dhe OJF-të janë pjesë e një rrjeti ndërkombëtar organizatash shoqërore që merren me shkeljen e të drejtave të njeriut në çdo vend të botës. Pra mund t'ju japin informacion për punën dhe shkeljen e të drejtave të fëmijëve.

Organizatat e punëtorëve dhe OJF-të

Disa prej tyre mund të jenë pjesëmarrëse në projekte që ndihmojnë fëmijët që punojnë dhe familjet e tyre. Ftojini këto organizata t'u flasin të rinjve të grupit rreth punës që kryejnë ose nxitini të rinjtë të takohen me përfaqësues të tyre.



Ç'duhet?

Materialet që duhet të përdorë grupi, kushtëzohen nga hapësira dhe mjetet që ka në dispozicion. Këto mjete që duhet të keni në dispozicion, ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Në shtesën 1 jepet informacion rreth botimeve dhe adresave të ndryshme në internet, të cilat janë shumë të dobishme për procesin e kërkimit që duhet të realizojnë të rinjtë. Gjithashtu, ju duhen:

- ✓ letër dhe lapsa;
- ✓ nëse është e mundur, lidhje me internetin;
- ✓ informacione nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe nga zyrat e punës në bashki për ligjet dhe normat që ekzistojnë në lidhje me arsimimin dhe punësimin e të rinjve;
- ✓ një dërrasë e zezë ose tabakë letre.

Zhvillimi i modulit

Organizimi i grupit



Organizimi i grupit kushtëzohet nga numri i pjesëmarrësve dhe vullneti i tyre për të marrë pjesë. Qëllimi i këtij moduli është t'i pajisë të rinjtë me njohuri rreth problemit të punës së fëmijëve. Natyrshëm, për këtë qëllim, vendi më i mirë për zhvillimin e modulit është klasa apo ndonjë vend i ngjashëm me të. Më pas, pjesëtarëve do t'u kërkohet që të realizojnë vetë procesin kërkimor, punë kjo që mund të bëhet nga secili më vete ose në grupe të vogla me dy-tre persona. Duhet të tregohet kujdes në ngritjen e grupeve që të funksionojnë sa më mirë dhe të gjithë të punojnë.

Nëse keni siguruar lidhjen me internet në shkollë apo bibliotekë, të bëni kujdes që të siguronit që të gjitha grupet të kenë mundësi të punojnë në kohë të barabartë si në kompjuter, ashtu dhe në internet.

Veprimtaria 1

Një botë e ndërlidhur

1 orë mësimi

Fillimisht të rinjtë duhet të kuptojnë pse është e rëndësishme të merren me dukurinë e punës së fëmijëve. Ka disa mënyra shumë të thjeshta për ta shpjeguar këtë koncept dhe vendi më i mirë për të punuar është klasa.

Kërkojuni të rinjve që në një fletë të bardhë të vizatojnë një rreth dhe në qendër të tij të shkruajnë emrin e vet. Emri duhet të shkruhet me gërma të vogla dhe të qarta. Përreth duhet të shkruajnë emrat e 10 personave të rritur që i njohin: prindër, të afërm, miq të familjes, komshinj, mësues, shitës etj.

Në përfundim, emri i tyre do të rrethohet nga 10 emra të rriturish. Kërkojuni që të vizatojnë një rreth tjetër dhe në të të shkruajnë emrat e të njohurve, të 10 personave të mëparshëm. Është e natyrshme që nuk do t'i njohin të gjithë personat, prandaj një pjesë të tyre do ta paraqiten me emrin e punës që bën, p.sh., punëdhënësi ose shoku i punës etj. Kërkojuni të gjejnë 10 emra të tjerë për secilin prej 10 personave të përcaktuar në fillim. Vazhdoni kështu, në mënyrë që, në tërësi, të arrijnë në 111 emra për çdo fletë.

Më pas, kërkojuni të bashkojnë me vijë emrat që mund të kenë lidhje ndërmjet tyre: kolegë pune, kushërinj, anëtarë të skuadrës së futbollit, mësues që njohin prindërit e nxënësve të tyre etj. Letra do të bëhet si një pëlhurë merimange e përshkuar nga vijat.



Rrathë koncentrikë gjithmonë e më të gjerë

Në këtë çast kërkojuni të gjejnë ndonjë emër tjetër që mund të shtojnë jashtë rrethit të fundit. Në rast se pranojnë, thuajuni ta shkruajnë. Ashtu si më parë, do ta lidhin me vijë emrin e ri me emrat e tjerë. Në fund, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të gjithë emrat do të jenë të lidhur me emrin që është shkruar në qendër të fletës.

Ndërsa punojnë për të shtuar emra të rinj dhe viza që i lidhin, tërhiqni vëmendjen e tyre pikërisht në këtë proces. Nëse secili prej të rinjve të grupit njih mesatarisht 100 të rritur dhe secili prej 10 të rriturve njih rreth 100 të tjerë, bëni një llogari të thjeshtë matematikore për të nxjerr se me sa persona janë të lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Lidhje të tërthorta

Këto lidhje shumfishohen me zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit. Shpjegojuni grupit që falë këtyre lidhjeve, ne duhet të marrim përsipër përgjegjësitë tona për atë që ndodh në botë.

Një lidhje tjetër shumë interesante që duhet të bëni, është prodhimi i mallrave të ndryshme dhe ç'nënkuptojnë këta mallra, kjo përsa i përket lidhjeve të padukshme. Ky ushtrim mund të zhvillohet pas ushtrimit të mëparshëm, por këtë radhë pa shkruar. Bëhet fjalë për një shkëmbim gojor të informacionit në grup.

Nëse dëshironi të nxisni të rinjtë të flasin për një çështje të caktuar, drejtojuni pyetjet e radhitura më poshtë apo dhe pyetje të tjera që ju vijnë në mend.

- A keni blerë kohët e fundit rroba të prodhuara në Kinë, Azi, Indi, Amerikë (të rinjtë mund të kontrollojnë etiketat e rrobave)?
- A merreni me ndonjë sport që përdor mjete të prodhuara jashtë shtetit (topa basketbolli, futbollit, tenisi etj.)? A e dini ku prodhohen këta artikuj (dy nga prodhuesit më të mëdhejnj të topave të sportit janë India dhe Pakistani)?
- A keni blerë pajisje të vogla elektrike, me çmim të ulta nga Kina dhe vendet e tjera të Azisë?
- A keni ngrënë çokollata apo a keni pirë kafe dhe çaj të prodhuar nga kompanitë shumëkombëshe?
A keni blerë lule për dhurata?

- A keni udhëtuar ndonjëherë jashtë shtetit dhe a keni fjetur në një hotel?


Shkruajini të gjitha përgjigjet në dërrasën e zezë ose në fletët e letrës. Nxitini të rinjtë të japin përgjigje duke e zgjeruar problemin që trajtojnë, si, p.sh., me ç'sport merren, si i kanë kaluar pushimet etj., duke e bërë interesante bisedën për grupin. Më pas, në një çast të përshtatshëm pyetini nëse u ka rastisur të takojnë fëmijë që punojnë. Madje, kjo pyetje mund të shtrihet edhe për personat e tjerë që kanë përmendur në ushtrimin e mëparshëm dhe që ata i njohin. Shpjegojuni të rinjve cilat janë arsyet e kësaj gjendjeje:



- Puna e fëmijëve përdoret shumë në prodhimin e artikujve të ndryshëm të tekstit dhe të artikujve sportivë që eksportohen;
- Puna e fëmijëve përdoret në florikulturën e vendeve afrikane dhe të Azisë Qendrore;
- Fëmijët punojnë në plantacionet e kakaos (prodhimi i çokollatës), të çajit në Afrikë dhe në Amerikën Qendrore;
- Në të gjithë botën, puna e fëmijëve përdoret në industrinë ushqimore në proceset e përgatitjes së ushqimeve;
- Puna e fëmijëve përdoret në sektorin e turizmit për punë të ashtuquajtura të padukshme, si: në lavanderi, në pastrim etj.;
- Puna e fëmijëve përdoret në disa sektorë të prodhimit si në vendet e pazhvilluara, ashtu dhe në vendet e zhvilluara, si: në prodhimin e pajisjeve elektrike, të instrumenteve kirurgjikale, aksesorëve të modës, prodhimit të artikujve prej xhami, porcelani etj.

Pothuajse të gjithë të rinjtë në grup do të jenë në gjendje të gjejnë një lidhje të tërthortë me punën e fëmijëve. Qëllimi i këtyre dy ushtrimeve është të zhvillohet te të rinjtë ndjenja e përgjegjësisë ndaj punës së fëmijëve.

Shndërrimi i numrave në realitet



Bëhet fjalë për një ushtrim të thjeshtë imagjinatë që i ndihmon të rinjtë të perceptojnë numrin e fëmijëve që punojnë në të gjithë botën. Ushtrimi duhet të zhvillohet në një atmosferë të qetë. Ftojini të rinjtë të ulen sipas dëshirës (në këtë ushtrim nuk ka rëndësi si vendosen). Ajo që ka rëndësi, është të kenë mundësi të lëvizin lirshëm në klasë. Ndoshta për disa ky ushtrim është i vështirë dhe nuk dëshirojnë të marrin pjesë. Ata janë të lirë të zgjedhin të marrin apo jo pjesë në zhvillimin e tij. Ushtrimi është shumë i shkurtër.

Është mirë që gjatë ushtrimit të rinjtë të mbajnë sytë mbyllur, ndërsa ju do t'i udhëhiqni në një udhëtim imagjinar. Kërkojuni të imagjinojnë sikur po ecin në një rrugë të drejtë dhe të ngushtë. Në të djathtë të tyre ka një rresht fëmijësh të ndotur, të pangrënë, të veshur me lecka, të zbathur që i fiksojnë me një vështrim të trishtuar. Ata janë të vendosur në mënyrë të tillë që në çdo dy hapa ka një fëmijë.

Kërkojuni grupit t'i shikojë këta fëmijë në sy dhe të mos i vidhet vështrimit të tyre, përkundrazi t'i japë shpresë dhe forcë.

Thojini grupit që udhëtimi i tyre filloi në orën 8 të mëngjesit, pasi kishin ngrënë një mëngjes të bollshëm (kjo do t'i bëjë të ndihen edhe më keq përpara syve dhe fytyrave të raskapitura të fëmijëve që punojnë). Grupi vazhdon udhëtimin e vet në rrugën e drejtë dhe të ngushtë dhe në çdo dy hapa takon një fytyrë fëmije. Nxitini të rinjtë të shtrijnë dorën drejt fëmijëve, t'i prekin, ndërsa vazhdojnë të ecin.

Grupi ecën, ecën dhe ecën gjatë gjithë ditës. Në mesditë ndalon dhe kthen kokën prapa për të parë gjithë rrugën që ka përshkruar. Rreshti i fëmijëve është shumë i gjatë dhe të gjithë kthejnë kokën nga grupi i fëmijëve që ecën në rrugë. Janë miliona sy të trishtuar që luten dhe luten në heshtje për ndihmë. Më pas, grupi kthehet dhe vazhdon rrugën që është e mbushur me fëmijë të tjerë derisa u kap shikimi. Vazhdojnë të ecin përgjatë rrugës.

Ecini gjithë ditën deri sa bëhet natë. Gjithmonë ka një rresht fëmijësh përpara dhe mbrapa tyre. Ndalen pasi kanë ecur për 14 orë rresht pa pushim, janë të lodhur dhe kanë parë të rreshtuar rreth 80 000 fëmijë. Thojuni të rinjve se në vendet e Amerikës Latine ky është numri i fëmijëve që punojnë në vendet ku hidhen plehërat. Ata kërkojnë nëpër plehëra gjëra që mund të hahen apo të rishiten.

Tani grupi ndalon dhe vendoset në të djathtë të rrugës, përballë rreshtit të fëmijëve për të fjetur. Fëmijët i shikojnë ndërsa ata i zë gjumi.

Duke u mbështetur në statistikat që jepen në modulën "Informacioni kryesor", kërkojuni fëmijëve të imagjinojnë rreshtin jashtëzakonisht të gjatë të fëmijëve që punojnë. Kujtojuni që gjatë ecjes së asaj ditë kanë takuar rreth 80 000 fëmijë. Në botë ka rreth 186 milionë fëmijë të moshës 5-14 vjeç që punojnë. Kërkojuni të rinjve të llogarisin sa ditë u duhet të ecin përgjatë rreshtit të fëmijëve që punojnë.

- Në Azi dhe vendet e Paqësorit (numërohen rreth 127 milionë);
- Në Amerikën Latine dhe Karaibe (numërohen rreth 17,5 milionë);
- Në Afrikën Subsahariane (numërohen rreth 48 milionë);
- Në vendet e industrializuara (numërohen rreth 2,5 milionë).

Nëse keni të dhëna të tjera statistikore, përdorini në këtë ushtrim.

Kërkojuni të rinjve t'i mbajnë sytë e mbyllur dhe të imagjinojnë të gjitha fëmijët që punojnë për gjatë rrugës imagjinare. Më pas kthejini në relitet duke u thënë të hapin sytë.



Është shumë e rëndësishme t'u jepni mundësi të rinjve të shprehin rreth përvojës që jetuan, të shprehin me fjale emocionet e tyre.



Shënim për përdoruesin

Kini parasysh që ky lloj ushtrimi imagjinar nuk është i zakonshëm dhe fëmijët nuk janë të përshtatshëm. Fëmijët përdorin imagjinatën kur janë shumë të vegjël deri në shkollën fillore. Fatkeqësisht, në arsimin e mesëm të ulët, në shumë vende nuk përdoret shumë imagjinata. Që ushtrimi të jetë i vlefshëm, duhet një farë praktike për krijimin e kësaj gjendjeje mendore. Mos u habitni që ky ushtrim jep rezultat pas një farë kohe. Varet shumë dhe nga mënyra si ju do t'u flisni fëmijëve, gjuha dhe intonacioni që do të përdorni, në mënyrë që të nxisni fantazinë e tyre, ndërsa përpiqen të imagjinojnë rrugën e gjatë.

Suksesi i këtij moduli varet shumë nga fantazia dhe krijimtaria fëmijëve. Në të përdoren të gjitha format artistike vizive, të shkruara dhe interpretuese, për të krijuar një impakt sa më të qëndrueshëm. Prandaj është mirë që të nxitet në vazhdimësi imagjinata.

Veprimtaria 2

Puna e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut

1 orë mësimi

Tashmë që grupi ka krijuar një ide për punën e fëmijëve, për numrin e fëmijëve që punojnë dhe lidhjet e shumta të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta që ekzistojnë, ka ardhur koha të zhvillohet diskutimi për natyrën e punës së fëmijëve, duke e trajtuar edhe në kuadrin e të drejtave të njeriut. Puna e fëmijëve është një problem që lidhet me të drejtat e njeriut dhe një nga shkeljet e tyre më flagrante. Gjithësesi, para se të zhvilloni këtë diskutim, duhet të njihni nivelin e njohurive të fëmijëve për të drejtat e njeriut, të shkeljes së tyre dhe të qëndrimit të shoqërisë kundrejt këtij problemi. Ky është një rast i mirë për të paraqitur disa nga konventat kryesore në lidhje me të drejtat e njeriut dhe, veçanërisht, konventat që lidhen me punën e fëmijëve.

Për këtë mund të veproni në dy mënyra. Në fazën përgatitore të modulit mund të fotokopjoni tekstet e konventave, nëse i keni ato në dispozicion, mund të shpërndani tekstet e tyre (një pjesë e tyre gjendet në materialet e kësaj pakete).

Caktoni një zëdhënës të grupit. Ai duhet të shkruajë në dërrasën e zezë çështjet dhe opinionet kryesore që dolën nga diskutimi. Qëllimi është të qartësohet lidhja që ekziston ndërmjet punës së fëmijëve dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi. Pyeteni grupin se ç'kupton kur flitet për të drejtat e fëmijëve. Gjatë zhvillimit të diskutimit thëlloni të kuptuarit e konceptit, duke i nxitur të shprehin opinionin e tyre në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe pse ndodhin, nëse ata kanë ndonjë njohuri për raste konkrete të lexuara apo të dëgjuara.



Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut

Ç'është një konventë ndërkombëtare

Konventat janë marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet shteteve që bazohen në rregulla sjelljesh, të parashikuara në ligje, të pranuar nga shumica e tyre. Qeveritë që ratifikojnë dhe nënshkruajnë marrëveshjet, duhet t'i përfshijnë ato në kuadrin ligjor të vendit dhe të punojnë që t'i zbatojnë. Nëse një vend është shumë i varfër dhe shumë i shtrirë, nuk është e lehtë të sigurosh zbatimin e të gjitha ligjeve. Duhet të ketë persona të veçantë që të kontrollojnë zbatimin e ligjit, p.sh., në rastin e punës së fëmijëve të ketë një inspektor të punës. Këto janë veprimtari që kushtojnë dhe vëndet e varfëra e kanë të vështirë t'i përballojnë. Për vëndet me sipërfaqe të madhe vështirësia lidhet me numrin e madh të vendeve të punës që duhet të kontrollojnë. Në praktikë ka shumë vende që kanë nevojë për ndihmë dhe mbështetje. Për problemin e punës së fëmijëve, këtë ndihmë mund ta marrin nga IPEC-u.

Gjatë zhvillimit të diskutimit dhe nxjerrjes në pah të rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut, përpiquni t'i përmbledhni medimet, duke ndihmuar kështu personin që merr shënime, dhe shkruajini ato në dërrasën e zezë, në mënyrë që asgjë të mos humbasë. Nxisni debatin dhe shkëmbimin e mendimeve, në mënyrë që gjithnjë të shprehin mendimin e vet. Nëse grupi nuk arrinë të prekë çështjet kryesore, ju duhet të ndërhyni dhe ta orientoni diskutimin pikërisht në këto çështje, duke u përqendruar në temën e të drejtave të njeriut.

Nëse debati fillon të zbehet, mos nguroni të hidhni në diskutim çështje të tjera, p.sh., si mbrohen të drejtat dhe si këto të drejta bëhen të njohura për popullin. Qëllimi është që të fillohet të flitet për Deklaratën e Kombeve të Bashkuara dhe për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (kopja e saj është në këtë paketë). Përqendrohuni në këtë temë dhe nxisni debatin. Pyesni grupin se çfarë di për Kombet e Bashkuara, për rolin dhe funksionin e kësaj organizate. Pyesni nëse dinë se ç'është OKB dhe përmendni organizmat e saj më të njohur, veçanërisht ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës). Kjo do të ndihmojë grupin të kuptojë vëndin dhe rolin që ka ILO në mënjanimi e plotë të punës së fëmijëve.

Ky është një rast i mirë që të qarkulloni në grup kopje të Deklaratës Universale për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Nëse nuk keni kopje të mjaftueshme, vendosini ato në një kënd të klasës në mënyrë që të rinjtë të kenë mundësi t'i shfletojnë. Citoni të drejtat më kryesore dhe kërkojuni të rinjve të shprehin nëse dinë ndonjë rast të shkeljes së këtyre të drejtave në vëndin e tyre dhe në botë. Diskutoni rreth tyre dhe nxitini të shprehin se përse këto të drejta vazhdojnë të shkelen edhe pse janë sanksionuar 50 vjet më parë në një dokument ndërkombëtar. Pyetini gjithashtu nëse këto të drejta shkelen në një vënd, a duhet të përpiqen t'i japin fund kësaj shkelje vëndet e tjera apo duhet të mos përzihen? Pse? A mendojnë të njëjtën gjë edhe për punën e fëmijëve? Mos harroni që ju vetë po përpiqeni të ngjallni tek të rinjtë një ndjenjë shqetësimi dhe përgjegjësie kundrejt fëmijëve që punojnë.

Ndërsa diskutoni për të drejtat e njeriut, filloni të fusni konceptin e të drejtave të fëmijëve dhe pyeteni grupin nëse fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejta të veçanta, të cilat duhet të respektohen nga të rriturit dhe autoritetet shtetërore. Edhe një herë caktoni një pjesëtar të grupit të mbajë shënim mendimet që do të dalin nga diskutimi. Gjithashtu, pyetini nëse ka një instrument, të ngjashëm me Deklaratën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që mbron të drejtat e fëmijëve dhe që është ratifikuar pothuajse nga të gjitha vendet e botës. Qëllimi është të mësoni nëse e dinë se ka një konventë të OKB për të drejtat e fëmijëve (një kopje është në paketë).

Nëse është e mundshme, siguroni kopje të kësaj konvente dhe shpërndaheni në klasë ose vendoseni në një kënd të klasës, në mënyrë që të rinjtë të kenë mundësi ta lexojnë individualisht. Ballafaqoni mendimet e grupit me nenet e Konventës. Nëse nuk kanë dëgjuar për Konventën, ndaluni dhe diskutoni për nenet kryesore, p.sh., neni 28 për arsimin apo neni 32 që ndalon shfrytëzimin e fëmijëve për tregti.

Rimerreni problemin e organizatave të KB-së dhe ndaluni në diskutimin e ILO-s. Bëhet fjalë për një organizatë ndërkombëtare të punës që përpiqet të realizojë drejtësinë shoqërore në shtetet anëtare. Një ndër funksionet e saj kryesore është garantimi i respektimit të të drejtave themelore në punë. Ky funksion realizohet falë natyrës tripalëshe që ka (prania e tri palëve shoqërore: qeveri, pundhënës dhe sindikata. Nëse dëshironi të zgjeroni diskutimin rreth mënyrave të funksionimit të ILO-s, mund t'i referoheni modulit "Bota e punës").

Konventa e OKB për të Drejtat e Fëmijëve



Konventa 138 e ILO-s për moshën më të vogël të punës



Tërhiqni vëmendjen e grupit të Konventa 138 dhe shpjegojini që fushata për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve bazohet pikërisht në të. Nëse e keni në disa kopje Konventën, shpërndajeni në grup dhe pyetni nëse anëtarët e tij e dinë se cili është problemi kryesor me të cilin ballafaqohen kur trajtohet problemi i punës së fëmijëve. Qëllimi juaj në këtë çast është të jepni “një përcaktim” të punës së fëmijëve, si dhe të nxirrni në pah argumentet e të rinjve për përcaktimin e këtij koncepti (p.sh., në bazë të moshës së lejuar nga ligji). Dëgjojini me vëmendje përgjigjet dhe mbani shënime ato të vlefshmet. Zgjateni diskutimin derisa të dalë koncepti i drejtë.



Konventa për moshën më të vogël të punës jep një sërë drejtimesh në të cilat bazohen qeveritë e vendeve të ndryshme për të përcaktuar moshën më të vogël të punës për fëmijët. Fëmijët, para se të punojnë me kohë të plotë, duhet të kenë mbaruar arsimin e detyruar. Konventa u referohet edhe llojeve të punëve, të lehta (si punët e shtëpisë) dhe të vështira (si puna në minierë dhe puna natën). Është e vërtetë që Konventa është dokumenti më i plotë dhe më i rëndësishëm në luftën kundër punës së fëmijëve, por është gjithashtu e vërtetë që ajo përdor një gjuhë të ashpër, veçanërisht për të rinjtë, prandaj duhet të bëni kujdes të mos hyni shumë në detaje.

Kini parasysh që nuk është objektivi juaj të formoni një grup ekspertësh juridikë që do të punojnë për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve, por qëllimi është t'i ndihmoni të rinjtë të kuptojnë se ka organizata shumë të mëdha që ndihmojnë qeveritë për të zgjidhur këto probleme. Qëllimi juaj është t'i njihni në përgjithësi me përmbajtjen e konventave, pa u ndalur në detaje që do të ishin të vështira për të rinjtë.

Shpjegojuni të rinjve që qeveritë e vendeve të ndryshme duhet të përfshijnë në mënyrë të përshtatshme këto konventa në legjislacionin e vëndit të tyre. KB nuk qeverisin botën, por ndihmojnë me këshillime, atje ku është e nevojshme. Nëse dikush nga grupi ngre çështje interesante për diskutim, si, p.sh., “Meqë ekzistojnë këto konventa,

pse është kaq i rëndësishëm problemi i punës së fëmijëve?" apo "Pse në botë shkelen të drejtat e njeriut?" etj., vazhdoni të diskutoni. Këto janë probleme që mund të çojnë në një debat filozofik më të gjerë rreth zhvillimit politik, shoqëror, ekonomik dhe botëror. Të njohësh opinionet e të rinjve rreth këtyre çështjeve, është interesante.

Nëse diskutimi ecën mirë, mund të trajtohen tema rreth dobisë së konventave, qëllimet dhe misioni i organizatave të KB etj. Nëse këto çështje nuk dalin, atëherë ju duhet të bëni pyetje të drejtpërdrejta rreth tyre. Duhet të theksoni që zbatimi i konventave realizohet mbi bazën e respektit, të përgjegjësisë dhe përfshirjes së shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Në këtë çast të zhvillimit të modulit, duhet të flisni për Konventën 182 të ILO-s. Kjo Konventë e vitit 1999 është për mënjanimin e plotë të formave më të këqija të punës. Duhet të nënvizoni faktin që pavarësisht ekzistencës së kësaj konvente, si dhe hartimit të shumë ligjeve në nivel kombëtar, puna e fëmijëve përbën një problem shumë të madh, pasi kjo punë ekziston edhe sot në shumë vende të botës. Një ndër çështjet që i prek thellë të rinjtë, kur flitet për punën e fëmijëve, është fakti se "edhe pse me këtë dukuri merren prej shumë kohësh njerëz të shumtë, shtetet dhe organizatat të fuqishme ndërkombëtare, puna e fëmijëve mbetet ende një problem shumë i madh". Pra çështja për këta të rinj është si mund të ndihmojnë ata në fushatën për mënjanimin e saj të plotë.

Kjo është një çështje shumë e rëndësishme që duhet ta ngrini qysh në fillimin e realizimit të modulit. Në grup duhet të përforconi mendimin se për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve është e nevojshme ndihma dhe mbështetja e të gjithëve, në mënyrë që në front të gjerë të punohet në këtë drejtim.

***Konventa e ILO-s
182 për format
më të këqija të
punës së fëmijëve***

Konventa jo vetëm përcakton kufirin e moshës më të vogël për punë, por në mënyrë të veçantë merret me format më të këqija dhe të dëmshme të punës, siç janë: prostitucioni, shfrytëzimi i fëmijëve-ushtarë, trafikimi i drogës dhe veprimtari të tjera të rrezikshme.

Përshkruani shkurtimisht rezultatet që kërkon të arrijë konventa nëpërmjet programeve. Para se të kaloni në trajtimin më të gjerë të problemit të punës së fëmijëve, ndaluni pak, aq sa duhet, në Konventë, për të cituar format më të këqija të punës dhe rëndësinë e saj.



Shënim për përdoruesin

Nënvizoni faktin që ekzistojnë ligje dhe mjete që sigurojnë që fëmijët të jetojnë plotësisht fëmijërinë e tyre dhe të arsimohen. Shoqëria dhe anëtarët e saj, veçanërisht punëdhënësit, përfshirë këtu edhe të rinjtë, duhet të zbatojnë këto konventa. Të gjithë kemi një rol për të luajtur në kuadër të kësaj fushate. Objektivi ynë është të shtojmë njohuritë tona për problemin dhe t'i shpërndajmë ato.

Dokumenti i fundit që duhet t'i paraqisni grupit është Deklarata e ILO-s për parimet e të drejtat themelore në punë, si dhe shtesa që i është bërë në qershor të vitit 1998. Edhe pse nuk ka të njëjtin status si konventat e mëparshme, mbetet një dokument i rëndësishëm sepse rritet solemnisht angazhimin e ILO-s dhe të shteteve anëtare për të respektuar dhe për të promovuar 4 të drejtat që vijojnë:

1. Lirinë e mbledhjes dhe të njohjen të së drejtës për të lidhur kontratë kolektive të punës (të drejtat themelore të sindikatës);
2. Mënjanimi i plotë i të gjitha formave të punës së detyruar;
3. Mënjanimi i vërtetë i punës së fëmijëve (parimi kryesor i SCREAM-it)
4. Mënjanimi i plotë i pabarazisë në punë (ç'dolloj diskriminimi).

Nënvizoni rëndësinë e parimit të tretë. Në fakt, të gjitha shtetet anëtare janë zotuar për të mënjanuar plotësisht punën e fëmijëve. Ky zotim është i njëjtë për të gjitha vendet, pavarësisht traditës dhe nivelit të zhvillimit ekonomik, kulturor, historik, si dhe numrit të konventave të ratifikuara të ILO-s. Bëhet fjalë për një instrument ndërkombëtar, pa precedent. Për vetë ILO-n është një detyrim më i madh për të mbështetur të gjitha vendet që kanë nevojë për ndihmë, p.sh., për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve.

Shpjegojini grupit si funksionon zbatimi i Deklaratës dhe shtesës që e shoqëron, nëpërmjet përdorimit të dy instrumenteve kryesore: *kontrollit vjetor* dhe *raportit global*. Kontrolli vjetor ka të bëjë me raportet që përgatisin shtetet që nuk kanë ratifikuar dokumentet dhe konventat e mësipërme për gjendjen e respektimit dhe të zbatimit të tyre. Gjithashtu, duhet të nënvizoni faktin që në këtë proces janë të nxitur të marrin pjesë si organizatat e punëtorëve, ashtu dhe ato të punëdhënësve për të bërë komentet dhe vlerësimet e tyre në lidhje me raportin e qeverisë.

Këshillojeni grupin që të diskutojë rreth këtyre çështjeve me përfaqësues të sindikatave apo të punëdhënësve që njohin apo që kanë marrë pjesë në realizimin e moduleve të tjera. Atyre mund t'u kërkohet se ç'dinë për Deklaratën

Deklaratat e ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë dhe shtesa përkatëse



Shënim për përdoruesin

Nëse keni akses ne internet rreth këtij problemi mund të gjeni më shumë informacion në faqen e internetit të ILO-s. Thjesht shkoni në faqen e ILO-s www.ilo.org dhe ndiqni faqet që lidhen me Deklaratën.

dhe ç'kanë bërë për ta promovuar atë. Gjithashtu, mund t'u kërkohet të flasin për ndihmesën që kanë dhënë për përgatitjen e raportit vjetor, nëse kanë qenë bashkautorë të përgatitjes së tij apo vetëm kanë dhënë mendime dhe kanë bërë vërejtjet e tyre. Raporti duhet të ketë informacion për punën e fëmijëve. Ndoshta grupi do të dëshirojë të dijë se ç'është shkruar për punën e fëmijëve në një material të përgatitur nga qeveria. Ndoshta përfaqësuesit do të habiten nga natyra e pyetjes dhe nuk do të dinë të përgjigjen. Mos u mërzisni. Kjo është pjesë e procesit të të mësuarit që ndihmon grupin të rivlerësojë rolin e vet në promovimin e Deklaratës, të parimeve të saj dhe të drejtësisë shoqërore, në kuptimin më të gjerë. Të gjithë duhet të luajmë një rol.

Raporti global përgatitet çdo vit, por, në dallim nga raporti i kontrollit vjetor, përqendrohet vetëm në zbatimin e një prej parimeve dhe të të drejtave. Dhe kjo është e detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare të ILO-s, pavarësisht nëse e kanë ratifikuar apo jo konventën që ka lidhje me to. Në harkun e 4 vjetëve, shqyrtohen të katra kategoritë e parimeve dhe të drejtave. Në vitin 2002 u analizua puna e fëmijëve.

Në përfundim, të rinjtë e grupit duhet të kuptojnë se Deklarata është një instrument ndërkombëtar që përdoret për të analizuar gjendjen e respektimit dhe të zbatimit të katër parimeve dhe të drejtave nga shtete anëtare të ILO-s, të cilat, nga ana e tyre, janë të lidhura me zbatimin e drejtësisë shoqërore në të gjithë botën.

Veprimtaria 3

Përçqasja e figurave

1 orë mësimi

Ky është një ushtrim ndërveprues që i ndihmon të rinjtë të kuptojnë çështjet më kritike të konventave nëpërmjet përçqasjes së figurave, të cilat mund të shërbejnë si hyrje në paraqitjen e konventave të tjera ose të plotësojnë veprimtaritë që tashmë janë zhvilluar.

Paraprakisht shkruani në dërrasën e zezë ose në tabakë letre çështjet kryesore apo deklaratat kryesore të të tria konventave: Konventa e KB për të drejtat e fëmijëve dhe konventat e ILO-s 138 dhe 182. P.sh., "Shtetet anëtare njohin të drejtën e fëmijës për arsimim" ose " Shtete anëtare njohin të drejtën e fëmijës që të mos shfrytëzohet për qëllime ekonomike". Shkruani me gërma të mëdha dhe të qarta deklaratat në mënyrë që të gjithë t'i lexojnë pa vështirësi. Është e rëndësishme që fraza të jetë e shkurtër dhe e kuptueshme.

Gjithashtu, përdorni burime të ndryshme informacioni (shiko modulën "Figura"), përzgjidhni figura, fotografi të riprodhuara në gazeta, revista, libra dhe broshura që paraqesin fëmijë që punojnë, që i nënshtrohen dhunës dhe shfrytëzimit ose fëmijë të rrugës dhe të uritur. Krahas fotografive që shprehin shkeljen e të drejtave të fëmijëve të paraqitura në Konventë, kërkoni dhe gjeni fotografi të tjera që shprehin forma të tjera të shkeljes së të drejtave të fëmijëve: një person që rrihet nga policia, të pastrehë, shpërngulje të refugjatëve, një grua viktimë e keqtrajtimit etj. Këto fotografi dhe figura do të përdoren gjatë diskutimit përfundimtar.

Shpërndajini këto figura në një tavolinë afër dërrasës së zezë apo tabakut të letrës ku keni shkruar deklaratat. Kërkojuni të rinjve t'i shikojnë figurat dhe të zgjedhin ato, të cilat, sipas mendimit të tyre ilustrojnë deklaratat. P.sh., një i ri mund të zgjedhë fotografinë e fëmijëve që punojnë në një fabrikë dhe e lidh këtë fotografi me deklaratën "Shtetet që kanë nënshkruar, njohin të drejtën e fëmijëve që të mbrohen nga shfrytëzimi ekonomik", pra të jenë të mbrojtur nga puna e fëmijëve.





Kërkojuni të gjithë anëtarëve të grupit të bëjnë të paktën një përjasje të figurës me një deklaratë dhe kërkojuni të shpjegojnë motivin pse kanë bërë këtë përjasje. Këkojuni të përiligjin të gjitha përzgjedhjet që kanë bërë: ç'mendojnë ata që është *e drejta*; si zbatohet kjo e drejtë për të gjithë dhe për ata si të rinj etj. Zhvilloheni debatin dhe shkëmbeni mendime derisa e shikoni që ka interes. Sigurohuni që të gjitha deklaratat e shkruara janë shoqëruar me informacione dhe figura nga të rinjtë. Ndodh që një figurë të lidhet me më shumë se një deklaratë. Ajo që është e rëndësishme, lidhet me faktin që ju duhet të bëni lidhjen që ekziston ndërmjet deklaratave dhe sistemit juridik të vendit tuaj. Kur këto të drejtat pasqyrohen në sistemin ligjor të vendit, atëherë qytetarët mund të kërkojnë respektimin e të drejtave të tyre në raste shkeljesh. Kjo zbatohet edhe për të drejtat e fëmijëve.

Në përfundim të diskutimit, paraqisni edhe informacionet dhe figurat e tjera që keni mbledhur për forma të ndryshme të shkeljes së të drejtave. Qarkullojini nëpër anëtarët e grupit dhe kërkojuni të shprehën se cilat janë të drejtat e shkelura. Diskutoni për diskriminimin, disa dukuri të të cilit nuk janë shumë ta qarta, si, p.sh., diskriminimi i gruas. Këto të drejta janë shumë të rëndësishme për të garantuar të drejtat e të gjithë anëtarëve të shoqërisë.

Më pas kalojeni diskutimin në temën e parandalimit të shkeljeve nga ana e qeverive dhe të shoqërisë, në përgjithësi. Trajtoni: ç'duhet bërë që të mos shkelen të drejtat themelore të njeriut dhe që të gjithë qytetarët të jenë të mbrojtur; a duhet të mbrohen në fakt të gjithë; a mendon grupi se jo të gjithë duhet të mbrohen dhe se ndonjëri nuk duhet të ketë ndonjë të drejtë të veçantë; kush konkretisht dhe pse.

Bëni kujdes që i gjithë diskutimi të ballafaqohet dhe të lidhë përmbajtjen e konventave ndërkombëtare të përshtatura nga organizata e KB me ligjet në fuqi të vendit. Nëpërmjet instrumenteve ndërkombëtare mund të përmirësohen ligjet e veçanta të vendeve të ndryshme në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Falë tyre, komuniteti ndërkombëtar mund të monitorojë dhe të shprehë mendimin e vet kundër praktikave të vendeve të ndryshme, madje edhe të ndërmarrë veprime konkrete

për t'i dhënë fund shkeljeve të të drejtave të njeriut. Shembuj të tillë ka shumë.

Konventat ndërkombëtare janë instrumente të rëndësishme që shërbejnë për arritjen e një objektivi themelor në lidhje me mbrojtjen e njeriut dhe, në veçanti, të njerëzve që janë më të dobët, si: gratë dhe fëmijët.

Veprimtaria 4

Copa të prera nga gazetatat

1 orë mësimi ose dhe më shumë

Kjo veprimtari mund të zhvillohet gjatë gjithë kohës së realizimit të moduleve, në fillim, në mes apo dhe në fund. P.sh., nëse e zhvillonit këtë modul pas modulit të kolazhit, të rinjtë duhet të jenë të përgatitur të mbajnë qëndrim më mirë rreth mungesës së vëmendjes që kanë mediat për punën e fëmijëve. Duke e marrë pikënisjen nga kjo, është logjike që t'u kërkoni të rinjve të ndjekin median e shkruar apo dhe televizive ku paraqiten raste të punës së fëmijëve apo për shkeljen e të drejtave të tyre. Nxiteni grupin të bëhet më përgjegjës për atë që ndodh, dhe të interesohet për këto probleme.

Qëllimi është që t'i nxisni të rinjtë të kontrollojnë gazetatat, revistat apo dhe publikimet e tjera në kërkim të artikujve dhe reportazheve që lidhen me pasqyrimin e punës së fëmijëve apo të temave të afërta. Edhe pse interesi i shtypit për këto probleme është i kufizuar, të rinjtë do të mësohen që të veçojnë ata artikuj që në një farë mase i referohen këtij problemi. Të rinjtë duhet t'i presin këta artikuj dhe të krijojnë fondin e tyre të artikujve të shtypit që do t'u shtohen materialeve të tjera që ata kanë përgatitur nga modulet e mëparshme.



Ky ushtrim është shumë i thjeshtë. Mund të zhvillohet nga i gjithë grupi ose nga nëngrupe të vogla. Ju përket juve të zgjidhni formën e përshtatshme për secilin anëtar të grupit. Gjatë procesit të kërkimit të artikujve në gazeta dhe revista mund të ndodhë që të rinjtë të ndalen në artikuj që nuk kanë ndonjë lidhje me temën. Edhe pse duhet t'u lini një farë lirie, pasi vetë leximi në vetvete është një burim shumë i mirë informacioni dhe njohurish, përpiquni që të mos dalin jashtë temës në kërkimin që bëjnë.

Bëheni këtë ushtrim vetëm një herë në javë, në mënyrë që të keni në dispozicion revista dhe gazeta të mjaftueshme për të nxitur dhe për të mbajtur gjallë interesin e të gjithëve.



Gjatë zhvillimit të këtij ushtrimi, mundohuni që të siguronit një klimë të qetë. Lëvizni ndërmjet të rinjve, ndërsa ata shfletojnë dhe kontrollojnë artikuj të ndryshëm. Nëse keni veçuar ndonjë artikull të rëndësishëm, me kujdes orientojeni vëmendjen e të rinjve në këtë problem. Nxisni debatin ndërmjet pjesëtarëve të veçantë të grupit, të cilët mund ta kenë vlerësuar këtë apo atë artikull si më me rëndësi për temën. Ky ushtrim intelektual thëllon dhe pasuron njohjen e tyre në lidhje me problemin dhe lidhjet e shumta që ka problemi i punës së fëmijëve.

Mos e zgjasni shumë ushtrimin, veçanërisht në rastet kur nuk keni një numër të rëndësishëm revistash apo gazetash, pasi humbet interesi. Në përfundim, kërkoni të rinjtë të bëjnë një përmbledhje të artikujve që kanë gjetur, dhe shkurtimisht të flasin për trajtimin e problemit. Edhe në këtë moment mund të nxisni debatin dhe pyetjet rreth mënyrës si artikulli ka trajtuar problemin. Kjo pjesë e ushtrimit duhet të jetë e shkurtër dhe e gjallë. Gjatë kalimit nëpër të gjithë artikujt e mbledhur, sigurohuni që secili prej tyre të skedohet dhe të futet në dosjen përkatëse, në mënyrë që të jetë e lehtë për të shfrytëzuar informacionin që duhet.



Kjo dosje mund të përdoret me frytshmëri gjatë zhvillimit të moduleve të tjera, si, p.sh., për debatin, ku pjesa kërkimore është shumë e rëndësishme. Nxiteni grupin që, nëse ka mundësi, të lexojë sa më shumë revista, gazeta, të dëgjojë emisione radiofonike dhe të ndjekë emisione televizive në lidhje me punën e fëmijëve. Shpjegojuni të rinjve që, nëse njerëzit e të gjitha vendeve nuk do të interesohen për atë çka ndodh në vende të tjera, probleme, si puna e fëmijëve etj., vetëm se mund të shtohen dhe shfrytëzimi i fëmijëve të rritet. Ky ushtrim është i thjeshtë dhe nuk ka kosto, por mund të nxisë interesin në rritje nga ana e të rinjve ndaj problemeve të ndryshme që i rrethon.



Shënim për përdoruesin

Nëse projekti zhvillohet në shkollë, bëni kujdes të përfshini edhe ndonjë mësues tjetër sipas përmbajtjes së temës.

Veprimtaria 5

Kërkimi

2 orë mësimi me një pushim në mes për të plotësuar realizimin e detyrave



Nga ana juaj kërkohet një pjesëmarrje tepër aktive në realizimin e veprimtarive të para. Në vazhdim i takon grupit të punojë në mënyrë të pavarur. Gjithmonë ekziston rreziku që t'i flisni shumë grupit. Përpiquni ta shmangni këtë gjë.

Është shumë e rëndësishme që grupi ta kuptojë se në fushatën globale për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve janë shumë të rëndësishme konventat ndërkombëtare të KB dhe të ILO-s. Konventat i ndihmojnë të konkretizojnë dhe të kuptojnë më mirë qëllimet për realizimin e këtyre veprimtarive. Por ekziston edhe një burim tjetër shumë i rëndësishëm informacioni, të cilin është mirë që ata ta zbulojnë vetë. Ndoshta keni marrë informacion nga IPEC-u apo organizata të tjera që merren me punën e fëmijëve. Ndoshta keni internet dhe, gjithashtu, keni informacion nga ndonjë sindikatë. Pra, shfrytëzoni të gjitha burimet e mundshme.

Mendoni t'i caktoni një detyrë grupit që do t'i duhet të zhvillojë një kërkim në mënyrë të pavarur. Jepuni të rinjve një listë me materiale edhe adresa interneti që mund t'i ndihmojë, të tjerat duhet t'i gjejnë vetë. Nëse është e nevojshme, mësojuni disa koncepte kryesore si duhet të kërkohen në internet.

Gjeni faqe interneti

Formoni grupe të vogla pune me 2 dhe e shumta me 4 veta secili dhe jepuni detyrën të gjejnë disa faqe web, 3 faqe interneti web për çdo grup, që japin informacion për punën e fëmijëve. Përveç gjetjes së adresave, të rinjtë duhet të bëjnë edhe një përmbledhje të përmbajtjes së faqes, organizatën që e ka krijuar këtë faqe, veprimtaritë e saj etj. Për të shkruar këtë përmbledhje, grupi të analizojë me seriozitet materialin dhe në fund të përgatisë një material me shkrim. Në përfundim, mund të organizoni një seancë ku secili grup do të lexojë atë që ka shkruar. Këkojini grupit të caktojë një person ose

një grup personazh për të mbledhur materialet dhe për të krijuar dosjen përkatëse me këtë informacion që fotokopjohet dhe shpërndahet te të gjithë pjesëtarët e grupit.

Caktojuni nëngrupeve a personave të veçantë të përmbledhin informacionin që kanë gjetur në faqen e internetit ose materialet e mbledhur. Fleta e njoftimit të përmbajë 10 fakte të rëndësishme për punën e fëmijëve ose statistika dhe veprimtari të zhvilluara nga OJF-të. E rëndësishme është që secili nëngrup të ketë letrën e vet të njoftimit, duke përcaktuar saktësisht burimin e informacionit. Gjatë bisedës përmbyllëse, përfaqësues të nëngrupeve apo persona të veçantë ftohen të lexojnë njoftimin që kanë përgatitur. Përsëri informacioni i marrë do të shkruhet në një dokument të vetëm që do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve të grupit.

Përgatitja e njoftimit

Shënim për përdoruesin

Është shumë e rëndësishme që rezultatet e projektit të mos kenë vetëm një vlerësim. Gjithashtu, gjatë këtij vlerësimi nuk është mirë të krijoni situata ku të krahasohen punimet e një personi me ato të një tjetri apo dhe të një nëngrupi me një nëngrup tjetër. Qëllimi është të rrisni tek të rinjtë ndjenjën e përgjegjësisë vetjake, të rritjes dhe të pjekurisë. Në këtë mënyrë ata fillojnë të zhvillojnë një ndjenjë të përkatësisë në këtë projekt. Objektivi themelor i këtij moduli është rritja e besimit dhe aftësive komunikuese tek të rinjtë.



Ç'duhet bërë dhe ç'duhet mënjanuar




- Siguroni pjesëmarrjen e të gjithë pjesëtarëve të grupit në të gjitha sesionet e zhvillimit të modulit.
- Gjatë veprimtarive në grup përdorni humorin dhe bashkëbisedimin për të krijuar një mjedis të këndshëm.
- Nxitini pjesëmarrësit të marrin shënime dhe të luajnë rolin e relatorit duke i paraqitur çështjet kryesore gjatë diskutimit. Kjo është një përvojë shumë e mirë për të zhvilluar aftësitë e të rinjve që do t'i shërbejë edukimit të tyre të përgjithshëm.
- Edhe ju duhet të merrni në shënim faktet dhe problemet që ju bëjnë përshtypje gjatë diskutimit, madje IPEC-u do të jetë veçanërisht i interesuar për t'i patur këto shënim në formën e një raporti, në mënyrë që t'i pasqyrojë në ripërpunimin e moduleve.
- Gjatë zhvillimit të këtij moduli mos përdorni elementet e garës. Nuk duhet të krijoni mosmarrëveshje dhe fyerje në bashkëpunimin ndërmjet pjesëtarëve të grupit. E rëndësishme është të krijohen marrëdhënie të forta, të bazuara në besimin dhe ju duhet të punoni për të realizuar këtë gjë.
- Siguroni që të lexohet nga një copë nga të gjitha punimet e realizuara nga të rinjtë dhe jo të lexoni vetëm ato që ju mendoni se janë më interesante. Punët dhe opinionet e të gjithëve janë të barazvlefshme, prandaj duhet të ruani paansinë dhe të mos shprehni gjykime.
- Krijoni kushtet që në diskutimin përfundimtar të gjithë të shprehen lirshëm dhe hapur. Këto janë ushtrime të rënda, prandaj t'i jepni mundësi grupit të shfaqë tërë energjinë e grumbulluar.

Diskutimi përfundimtar

1 orë mësimi

Në varësi të përbërje së grupit, diskutimi i problemit “për lirinë e shprehjes” mund të jetë shumë interesant. Dukuria e punës së fëmijëve egziston në forma të ndryshme. Në disa raste bëhet fjalë për punë në bujqësi, në shtëpi apo në ndërmarrjen e krijuar nga familja. Në raste të tjera, fëmijët punojnë me kohë të pjesshme, në mbrëmje ose në fund të javës për të siguruar të ardhura për veten apo dhe për familjen. E rëndësishme është që të jeni të ndjeshëm ndaj situatës së familjeve të të gjithë pjesëtarëve të grupit.



Filloni diskutimin për veprimtaritë e mundshme që mund të kryejnë të rinjtë: a merren me sport; me ç’sport merren; si e kalojnë kohën e lirë; a ju pëlqen natyra etj. Lërinë të lirë të shprehen duke krijuar kështu një atmosferë qetësuese dhe çlodhëse.

Gjatë këtij diskutimi të lirë ju mund të gjeni çastin për të ndërhyrë dhe për të tërhequr vëmendjen për të folur rreth ndryshimeve që ka në mes të jetës së tyre dhe të fëmijëve që punojnë. Mendohet që të gjithë të rinjtë e grupit tuaj bëjnë një jetë të pasur me sport, me mundësi shkollimi dhe kënaqësi të tjera. Në këtë mënyrë ata rriten dhe përballojnë aspekte të veçanta të jetës, p.sh., si të jenë anëtarë të një grupit të një bashkësie dhe të shoqërisë, në tërësi, duke mësuar kështu se jemi qytetarë të botës.

Nënvizoni faktin se është pikërisht ky aspekt që u mungon fëmijëve që punojnë.

Pikërisht të gjitha këto mungesa, fëmijëve të tjerë që i kanë, u duken mëse të natyrshme, quhen me termat “fëmijëri e humbur” apo “ëndrra të humbura”. Ndoshta ende në jetën e fëmijëve që punojnë, do të ketë çaste moskokëçarjeje, por edhe këto do të jenë të lidhura me punën. Pyetini të rinjtë se cili është aspekti kryesor që i dallon ata nga fëmijët që punojnë. Le të shpresojmë se

të paktën njëri prej tyre të thotë: “Liria e zgjedhjes”.

Mund të ndodhë që ndonjëri prej të rinjve të grupit punon, por këtë e ka zgjedhur vetë. Ndoshta ka qenë i shtyrë prej prindërve, nga që ka dashur vetë, apo është shtyrë nga gjendja finaciare e familjes etj. Pavarësisht arsyes, ka qenë vetë ai që ka vendosur të punojë dhe asnjëri nuk e ka shtrënguar ta bëjë këtë gjë. Normalisht, asnjëri nuk u kërkon të rinjve të heqin dorë nga liria që kanë zgjedhur, e cila u krijon mundësi të venë në shkollë, të kenë kohën e tyre të lirë që e shpenzojnë si të duan përtej detyrimeve të tjera në punë. Por për fëmijët që punojnë, në pjesën më të madhe të tyre, gjërat nuk janë të tilla.

Vazhdoni bisedën dhe mundohuni të zbuloni se deri në ç’mase grupi i të rinjve është i ndërgjegjësuar për të drejtat që ka në vendin e vet.



Shënim për përdoruesin

Burimet kryesore të informacionit për të drejtat e të rinjve të përcaktuara në ligjet kombëtare, janë në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale. Vihuni në lidhje me persona përgjegjës të kësaj ministrie për të patur materialet që ju nevojiten. Shpesh ndodh që të përgatiten postera dhe broshura për të përfshirë të rinjtë në tregun e punës. Është befasues fakti që të rinjtë janë shumë pak të informuar për të drejtat e tyre.

Ky sesion realizohet në formën e rrahjes së mendimeve (brainstormingu). Kërkojini grupit të flasë për gjithçka di rreth të drejtave dhe shënojini ato në dërrasën e zezë ose në fletët e tabakut. Gjithashtu, kërkojuni të rinjve të thonë nëse e dinë sa është numri i orëve që duhet të punojnë, sa është paga minimale, oraret e punës së natës apo të mengjesit, oraret e pushimit dhe detyrimet e punëdhënësit, të përcaktuara të gjitha këto në ligje. Për IPEC-un është shumë e rëndësishme të përfshijë në fushatën globale të rinjtë, ndërkohë që të rinjtë e vendeve të ndryshme duhet të njihen me të drejtat e tyre në kushtet e vendit ku jetojnë. Meqë e gjithë kjo veprimtari zhvillohet në një koncept didaktik, është mirë që ju vetë të keni njohuri të mjaftueshme për informacionin kryesor që ju nevojitet.

Nëse keni informacion shtesë në formën e një materiali, bëni kujdes ta qarkulloni në të gjithë grupin dhe ta varni në një vend të dukshëm duke e nxitur grupin ta lexojë. Të rinjtë duhet t’i njohin të drejtat e tyre dhe nuk duhet të kenë frikë t’i kërkojnë ato. Madje, kjo përbën një dallim tjetër ndërmjet tyre dhe fëmijëve që punojnë. Këta të fundit nuk e dinë se janë këto të drejta,

ata nuk mund të njihen me to se nuk dinë të shkruajnë dhe të lexojnë. Kryesorja, askush nuk përpiqet t'ua bëjë ato të njohura. Madje ndodh që as punëdhënësi dhe as ata që punojnë bashkë me fëmijët nuk e dinë se puna e tyre është e ndaluar me ligj, duke e përligjur se përderisa ka ekzistuar gjithmonë, pse nuk duhet të jetë më. Arsimimi është një çështje shumë e rëndësishme për të gjithë: fëmijët, prindërit, punëdhënësit dhe autoritetet.

Vlerësimi dhe vazhdimi

Në kuadër të zhvillimit të modulit, mund të veçohen disa rezultate, megjithëse nuk është e lehtë t'i identifikosh ato në një periudhë të shkurtër. Gjithësesi, vetëm me kalimin e kohës dhe zhvillimin e moduleve të tjera, ju do të jeni në gjendje të krijoni një ide të saktë për suksesin e këtij moduli.

Ky modul është shumë i rëndësishëm, madje mund të thuhet që është baza për realizimin e moduleve të tjera, sepse i jep grupit njohuri bazë për të kuptuar punën e fëmijëve. Pa këtë informacion, është e vështirë të vazhdosh realizimin e projektit. Gjithësesi mos e zgjasni më shumë seç duhet.

Pasi të keni përfunduar këtë modul, mund të kaloni në realizimin e modulit "Intervista dhe sondazhi". Të dyja këto module janë një bazë solide që e rrit shkallën e ndërgjegjësimit të të rinjve për rolin që duhet të luajnë në ndryshimet shoqërore.



Shtesa 1

Faqe web me informacione për punën e fëmijëve

Emri i organizatës	Adresa në internet	Profili i shkurtër
Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC)	www.il.org/public/english/standards/ipec	Në fillim të viteve '90 ILO organizoi një ndërmarrje të fuqishme kundër punës së fëmijëve nëpërmjet programit të IPEC-ut, duke i ndihmuar shtetet anëtare të ndërmernin politika dhe programe për të zgjidhur këtë problem
Fondi i KB për fëmijët (UNICEF)	www.unicef.org	UNICEF është organizatë e KB që merret me probleme të fëmijëve, ndër të cilat dhe me punën e tyre.
Shoqëria kundër skllavërisë	www.anti-slaverysociety.org	IJF e specializuar që ka shumë informacion në faqet e internetit
Marshimi global kundër punës së fëmijëve	www.globalmarch.org	Faqe web e organizatorëve të marshimit global në vitin 1998. Përmban informacion për marshimin, informacion themelor për punën e fëmijëve, si dhe lidhje me organizatat e tjera të perfshira
Federata Ndërkombëtare e Puntorëve të Ndërtimit dhe Drurit	www.ifbwww.org	Shoqatë sindikaliste që ka zhvilluar një fushatë për të mënjeluar punën e fëmijëve në ndërtim

Emri i organizatës	Adresa në internet	Profili i shkurtër
Federata Ndërkombëtare e Arsimit (EI)	www.ei-ie.org	Organizatë ndërkombëtare që përfshin mësuesit që punojnë në fushatën kundër punës së fëmijëve veçanërisht në sektorin e përgatitje së mjeteve didaktike
Bashkimi i Rrjetit Ndërkombëtar (UNI)	www.union-network.org	Organizatë ndërkombëtare që zhvillon fushatë kundër punës së fëmijëve në sektorin e tregtisë në të gjithë botën
Konfederata Ndërkombëtare e Sindikatave	www.ituc.org	Organizatë ndërkombëtare e sindikatave që zhvillon fushatë kundër punës së fëmijëve në sektorin e tregtisë në të gjithë botën.
Bashkimi ndërkombëtar i punëtorëve të industrisë ushqimore, të ushqimit, të turizmit, të duhanit (IUF)	www.iuf.org	Organizatë që zhvillon fushatë kundër punës së fëmijëve në një sektor shumë të rëndësishëm, siç është bujqësia
Shërbimi ndërkombëtar publik	www.world-psi.org	Organizatë ndërkombëtare e punëtorëve të sektorit publik që po zhvillon një fushatë për ndalimin e përdorimit të veglave të prodhuara nga fëmijët nëpër spitale.
Lirojini fëmijët	www.freethechildren.org	Enti zyrtar bamirës në ShBA, me programe dhe veprimtari që kanë synim të reduktojnë varfërinë dhe shfrytëzimin e fëmijëve në të gjithë botën
Një botë	www.oneworld.org	Është një komunitet me 250 organizata on-line, që kanë të njëjta parime për drejtësinë shoqërore dhe të drejtat e fëmijëve dhe luajnë një rol të rëndësishëm

Emri i organizatës	Adresa në internet	Profili i shkurtër
Federata Ndërkombëtare e Arsimit (EI)	www.amnesty.org	Rrjeti botëror i organizatave që së bashku punojnë për të drejtat e fëmijëve
Rrjeti i informimit për të drejtat e fëmijëve	www.crn.org	Rrjeti i organizatave botërore që japin informacion dhe përvijë për temën e punës së fëmijëve
Aleanca botërore e YMCA	www.ymca	Rrjeti botëror i YMCA që merret me shfrytëzimin e fëmijëve në të gjithë botën me të gjitha format dhe filialet e saj që punojnë për të mënjanuar punën e fëmijëve
Shoqata ndërkombëtare të grave të Paqësorit dhe Azisë Juglindore	www.ppseawa.org	Shoqatë ndërkombëtare e grave që merret me promovimin e paqes dhe bashkëpunimit të grave të këtij rajoni. Impenjimi i tyre shtrihet tek gratë dhe fëmijët
Sweatshop Watch	www.swatshopwatch.org	Është shoqatë e qytetarëve private që të gjithë së bashku luftojnë kundër punëve të vështira. Veprimtaria e tyre shtrihet në ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe krijimin e koalicioneve
Casa Alianza Covenant House Latin America	www.casa-alianza.org	Shoqatë që merret me riintegrimin dhe mbrojtjen e fëmijëve të rrugëve në Guatemalë, Honduras dhe Meksikë
Alberat Sports Pakistan	www.alberta-sport.com	Prodhuesit e topave të futbollit në Sialkot, Pakistan, që marrin pjesë në programin e ILO-s për mënjanimin e punës së fëmijëve në këtë sektor

Emri i organizatës	Adresa në internet	Profili i shkurtër
Koncepti i ri i sistemit ndërkombëtar	www.newconceptinfo.com	Grupi i profesionistëve aktivë në Indi që ofrojnë shërbime botimi në fusha të ndryshme të zhvillimit shoqëror dhe në punën e fëmijëve
Mbrojtja ndërkombëtare e fëmijëve	www.defence-for-children.org	OJF për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. Filialet e saj gjenden në të gjithë botën.
CAFOD	www.cafod.org.uk	CAFOD është agjencia për mbështetje dhe zhvillim i kishës katolike të Anglisë. Zhvillon një fushatë të rëndësishme kundër punës së fëmijëve në industrinë e veshjes
Green Net	www.gn.apc.org	Green net është pjesë e një rrjeti global kompjuterësh që destinohet për grupe të veçanta të mbrojtësve të mjedisit dhe pacifistëve që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe të zhvillimit. Ky rrjet ka 200 anëtarë
Banka Botërore	www.worldbank.org	Adresa e BB dhe instrucioneve të zhvillimit dhe financiare që varen prej saj
Informacioni kryesorë	www.essential.org	Një varg organizatash që ndajnë parime të njëjta në lidhje me zhvillimin dhe çështje humanitare
Agjencia e lajmeve për fëmijët (ANDI)	www.ando.org.br	Agjenci braziliane e shtypit që është shumë aktive në çështjen e të drejtave të fëmijëve
Labours of love	www.childlabor.org	OJF që siguron shkëmbimin e informacionit në lidhje me punën e fëmijëve për të bindur publikun të punojë me më shumë efektivitet për të promovuar edukimin dhe arsimimin e fëmijëve

Emri i organizatës	Adresa në internet	Profili i shkurtër
Children's House	www.child-house.com/childhouse	Qendër për shkëmbimin e informacionit për mbrojtjen e fëmijëve
Christian Aid	www.christian-aid.org.uk	Agjencia zyrtare e 40 kishave të Anglisë dhe Irlandës që luftojnë kundër shkaqeve të varfërisë
Co-op America	www.coopamerica.org	OJF në Amerikë që ndihmon për të zbatuar strategji ekonomike për ndërmarrjet private që të përballojnë probleme sociale
Change Net	www.changenet.sk	Komuniteti virtual i shoqatave slovake për shkëmbimin e informacionit
Terre des Hommes	www.tdh-geneve.ch	OJF zviceriane për bashkëpunimin dhe zhvillimin që ka bashkërenduar marshimin global në veprimtaritë e fundit në Gjenevë
Zhvillimi i veprimit mjedisor në Botën e Tretë (Enda)	www.enda.sn	OJF ndërkombëtare me bazë në Dakar dhe Senegal që merret me çështje të zhvillimit në vendet e Botës së Tretë
Save the Children	www.oneworld.org/scf/	Një ent shumë i rëndësishëm britanik që punon për fëmijët në të gjithë botën
Actionaid	www.actionaid.org	Një ent i rëndësishëm që punon për zhvillimin kundër varfërisë me 3 milionë të varfër në Afrikë, Azi dhe në Amerikë Latine
Aksioni për barazi, solidaritet dhe zhvillimin mjedisor (ASEED)	www.antenna.nf	Rrjeti global i të rinjve që merret me çështjet e zhvillimit e të mjedisit.

Emri i organizatës	Adresa në internet	Profili i shkurtër
Corporate Watch	www.corpwatch.org	Revistë dhe informacion në internet për çështje që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e ndërmarrjes, globalizmin, drejtësinë shoqërore dhe mjedisore.
Child Workers në Azi	www.cwa.tnet.co.th	CWA është një rrjet OJF-sh dhe personash privatë të përfshirë në luftën kundër punës së fëmijëve në vende të ndryshme të Azisë, ka lidhje me OJF në Bangladesh, Nepal, Pakistan, Indi, Laos, Kamboxhia, Tajlandë, Indonesi etj.
Këshilli i Evropës	www.coe.int	Kjo adresë përmban tekste të rekomandimeve, rezolutave, komunikatave të shypit për përfshirjen e tij në mënjanimin e punës së fëmijëve
Global Exchange	www.globalexchange.org	Është një qendër jofitimprurëse e kërkimit, arsimit dhe veprimit kushtuar tematikave të drejtësisë politike, ekonomike dhe shoqërore në shkallë globale. Qëllimi i saj është të sensibilizojë opinionin publik amerikan dhe të shtyjë të ndërmerren veprime konkrete
Departamenti për zhvillimin ndërkombëtar	www.dfd.gov.uk	Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar që merret me zhvillimin dhe punën e fëmijëve
USAID	www.usaid.gov	Agjensi e pavarur qeveritare që ofron ndihmë për zhvillimin ekonomik, humanitar dhe për promovimin e interesit ekonomik dhe politik të ShBA.

Emri i organizatës	Adresa në internet	Profili i shkurtër
Departamenti i Punës. Qeveria e ShBA	www.dol.gov	Departamenti i Punës merret me përgatitjen e forcës së punës amerikane për mundësi të reja punësimi dhe garanton përshtatshmërinë e vendin të punës
Shoqata amerikane e punonjësve të bujqësisë	www.afop.org	Kjo adresë ka të bëjë me fushatën e AFOP për eliminimin e punës së fëmijëve në bujqësi, në ShBA
UNITE	www.uniteunion.org	Adresa e bashkimit të sindikatave të punëtorëve të tekstilëve dhe veshjeve në ShBA me shumë informacion për punën e fëmijëve dhe punët e rënda
Programi ndërkombëtar për mbrojtjen e të rinjve (YAPI)	www.yap.org	Kjo adresë mbulon një tematikë të gjerë që lidhet me të rinjtë dhe zhvillon veprimtarinë e vet në të gjithë botën
Bashkimi Evropian (UE)	www.workingchild.org	Adresë jo shumë e rëndësishme përsa i përket informacionit, por që jep adresa dhe lidhje të reja
International Save the Children Alliance	www.savethechildren.net	Kjo adresë ofron lidhje dhe adresa të reja në lidhje me problemin e punës së fëmijëve
Levi Strauss & Co.	www.levistraus.com	Adresa e shumëkombëshes së prodhimit të xhinsave ka një seksion që merret me bursat e shkollimit për komunitetin. Kjo shoqëri financon disa projekte në fushën e së drejtës shoqërore.

Emri i organizatës	Adresa në internet	Profili i shkurtër
Reebok	www.reebok.com	Ka publikuar një deklaratë për të drejtat e njeriut në adresën e vet. Është dakord për krijimin e kushteve të përshtatshme të punës dhe për të mos shfrytëzuar punën e fëmijëve
Clean Clothes Campaign	www.cleanclothes.org	Promovon kushte më të mira pune në industrinë e veshjes dhe të artikujve sportivë. Veçanërisht aktive kundrejt dyqaneve që shesin artikuj të prodhuar me punën e fëmijëve.
UNDP in Albania	www.undp.org.al	Ka studime, projekte, botime që lidhen me fëmijët në Shqipëri
World Bank in Albania	www.worldbank.org/albania	Ka studime, projekte, botime që lidhen me fëmijët në Shqipëri
UNICEF in Albania	www.unicef.org/albania	Ka studime, projekte, botime që lidhen me fëmijët në Shqipëri
US Department of Labor 2003 Findings on the Worst Forms of Child Labour	http://www.dol.gov/ilab/media/reports/iclp/tda2003/overview.htm	Informacion për fëmijët që punojnë
Albanian Council of Ministers	www.keshilliministrave.al	Informacion për veprimtarinë e Këshillit të Ministrave (KM)
Ministria e Punëve të Jashtme	www.mfa.gov.al	Informacion për veprimtarinë MPJ
Ministria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve	www.mkrs.gov.al	Informacion për veprimtarinë MKTS
Ministria e Brendshme	www.mpo.gov.al	Informacion për veprimtarinë MB
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	www.mash.gov.al	Informacion për veprimtarinë MASH
Njësia e punës së fëmijëve në MPÇSSHB	e-mail: shmanaj@sanx.net	Informacion për veprimtarinë e NJPF

Shënime

A series of horizontal dotted lines for writing notes.